



**REPUBLIKA E KOSOVËS/
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

PPP.nr.22/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjykatësi Agron Hoxhaj, me sekretaren juridike Teuta Kabashi nga Prizreni, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorës së përmbarimit, K.R.M.'...' me seli në ..., Rr.'...' nr. ... në ..., kundër debitorit të përmbarimit, A.Sh nga ..., Rr.'...'nr. ... në ..., për përmbarimin e dokumentit të besueshëm të përmbarimit – Faturës me kartelën e konsumatorit nr. ... për vitet 2002 e deri me dt.1.shtator 2016 për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 329,25 tre qindë e njëzetë e nëntë eurove e një zetë e pesë centëve) dhe i lejuar me Urdhërin për përmbarim, P.nr.602/2016 të dt.06.10.2016 të Përmbaruesit privat, M.S.R nga ..., duke vendosur sipas prapësimit të ushtruar nga S.Sh nga ..., djali i debitorit të përmbarimit, A.Sh nga ..., kundër Urdhërit për përmbarim, P.nr.602/2016 të dt.06.10.2016 të Përmbaruesit privat, M.S.R nga ..., jashtë seancës gjyqësore, me dt.27.1.2017, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET poshtë si i pa lejuar prapësimi i ushtruar nga S.Sh nga ... në emër të debitorit së përmbarimit, A.Sh nga ..., tani i ndjerë, kundër Urdhërit për përmbarim, P.nr.606/2016 të dt.06.10.2016 të Përmbaruesit privat, M.S.R nga Prizreni.

A r s y e t i m

Përmbaruesi privat, M.S.R nga Prizreni, me Urdhërin për përmbarim, P.nr.832/2016 të dt.10.10.2016, ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorës së përmbarimit, Kreditorja e përmbarimit, K.R.M.'...'/Sh.a. me seli në ... i paraqitur kundër debitorit të përmbarimit, A.Sh nga ... dhe atë për përmbarimin e dokumentit të besueshëm të përmbarimit – Kartelën e konsumatorit nr. ... për vitet 2002 e deri me dt.1.shtator 2016 për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 329,25 tre qindë e njëzetë e nëntë eurove e një zetë e pesë centëve) në emër të shpenzimeve për mbeturina e pas dërgimit të këtij urdhëri për përmbarim, palëve në procedurë, njëri nga antarët e familjes së tani të ndjerit, debitorit të përmbarimit, A.Sh nga ..., me dt.7.12.2016, kundër këtij urdhëri, S.Sh nga ..., ka paraqitur ankesë (prapësim) e më gjerësisht me arsyet e dhëna si në këtë ankesë (prapësim) dhe se në këtë prapësim, ka cekur se babai i tij këtu debitori A.Sh nga ..., ka vdekur, dhe se për këtë ka ofruar si provë certifikatën e vdekjes të dt.16.9.2009 e më gjerësisht me arsyet e dhëna si në këtë prapësim, derisa pala kreditore në këtë prapësim, nuk ka paraqitur përgjigje.

Duke vepruar më tej në këtë çështje juridike të përmbarimit, ky Përmbarues Privat, me aktin e tij përcjellës, P.nr.602/2016 të dt.13.1.2017, kësaj gjykate me dt.13.1.2017, ia ka dorëzuar shkresat e lëndës P.nr.602/2016 përkitazi me vendosjen nga gjykata si organ kompetent i përmbarimit për prapësimin e ushtruar nga S.Sh nga ... (antari i familjes së tij) dhe në emër të debitorit të përmbarimit, A.Sh nga ... tani i ndjerë kundër Urdhërit për

përmbarim, P.nr.602/2016 të dt.06.10.2016 të Përmbaruesit privat, M.S.R nga ... dhe se kjo gjykatë, si organ përmbarues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ky prapësim si mjet i rregullt juridik i goditjes së vendimeve të nxjerra në procedurën e përmbarimit,

Është i pa lejuar

Me shikimin në shkresat e lëndës së përmbarimit, P.nr.602/2016 të Zyrës së Përmbaruesit privat, M.S.R na ..., gjykata si organ kompetent për vendosje për prapësimet e ushtruar kundër urdhërave për përmbarim të përmbaruesit privat, si në rastin konkret, vërtetoi faktin se kreditoja e përmbarimit, propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të besueshëm të lartëcekur të përmbarimit – Faturës gjegjëse me kartelë të konsumatorit për shkak të detyrimit të lartëcekur në të holla dhe i lejuar me Urdhërin e lartëcekur për përmbarim e me propozim të mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara në LPP për realizimin e detyrimit në të holla. Mirëpo, kundër Urdhërit të lartëcekur për përmbarim, prapësim, ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e tij dhe se për mënyrën e vendosjes së gjykatës për një prapësim të ushtruar kundër një Urdhëri për përmbarim të një përmbaruesi privat, si organ i përmbarimit dhe si lloji i vendimit që nxirret në procedurën e përmbarimit, në nenin 73 të LPP-së, thuhet se : *''Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar''*. Duke qenë se në rastin konkret, prapësimin si mjet të rregullt juridik të goditjes kundër një Urdhëri për përmbarim, të një përmbaruesi privat, si organ përmbarues, dhe si lloji i vendimit të nxjerrë në procedurën e përmbarimit, e ka ushtruar personi i pa autorizuar për paraqitjen e tij, andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë vendosi që prapësimin e S.Sh nga Prizreni nga Prizreni përndryshe djali i debitorit, A.Sh nga ..., tani i ndjerë të ushtruar kundër Urdhërit për përmbarim, P.nr.602/2016 të dt.06.10.2016 të Përmbaruesit privat, M.S.R nga ..., t'a hedh poshtë si të pa lejuar.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 3, 5, dhe nenit 73 të Ligjit të procedurës së përmbarimit (LPP).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN PPP.nr.22/2017, me dt.27.1.2017

**Sekretarja juridike
T. Kabashi**

**G j y k a t ë s i
Agron J. Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda afatit prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykatë.